**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A**

**Tiranë, më 23.07.2025**

# PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

## PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "BLERJE PAJISJE PËR TEATRIN KOMBËTAR"**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):**

38651100-4 Lente për kamera: 38651600-9 Kamera dixhitale

**VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS: 1,555,528** (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për proçedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Shtojca 8**

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi**: *Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 "Formulari permbledhes i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285,*

*datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik".*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi**: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c e 3 dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"te ndryshuar ku përcaktohet se: "Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së bisnesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave."*

*Në nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"te ndryshuar përcaktohet se:*
*"2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.*

*3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor."*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023"Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*
*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar, për procedurat nënkufirin e ulët monetar, vlerë e mjaftueshme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

**2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

   a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
   b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

***Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4/c të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

**2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose ekuivalent (e vlefshme)

**Argumentimi:** *Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020"Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: "1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."*
*Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar ku percaktohet se: "1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.*

*ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. ( e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë ). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.*

**3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike të prodhuesit për të gjithë artikujt objekt prokurimi, duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikujt e ofruar, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike të mallrave sipas dokumenteve të tenderit. Nëse

katalogu/ët / skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.*

*Kërkesa për katalogun /skedës teknike* të prodhuesit *ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.*

*Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog/skede teknike do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.*

**4.** Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 vjeçare të garancisë së mallrave objekt prokurimi ,nga data e dorëzimit të mallit.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor përfitues që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë.*

**5.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër shërbimin e transportit të mallrave pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor përfitues brenda afatit të parashikuar.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4,të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin, në adresen e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues,* brenda afatit të parashikuar.

**6.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4,të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë*

*19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, të papërdorura dhe pa dëmtime.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike :**

Specifikimet teknke janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues Teatri Kombëtar, nga pikëpamja teknike, ekonomike dhe funksionale, në përputhje me nenin 36 të ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.
SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".
*Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:*
*a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efiçencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
*b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*
*c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:
Specifikimi i Materialeve:
Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## 1. SPECIFIKIMET MINIMALE TEKNIKE PËR 1. APARAT FOTOGRAFIK PROFESIONAL

Sensori i imazhit
Raporti i pamjes
3:2
Numri i pikselëve (efektiv)
Për Minimalisht 33.0 MP
Numri i pikselëve (total)
Për Minimalisht 34,1 MP
Lloji i sensorit
Kornizë e plotë 35 mm (35,9 x 23,9 mm), sensori Exmor R CMOS
Sistemi kundër pluhurit
Po (veshja mbrojtëse e ngarkesës në filtrin optik dhe mekanizmin e zhvendosjes së sensorit të imazhit)
Pas
Sistemi i regjistrimit
Informacioni i vendndodhjes Lidhja nga smartphone
Pas
Mediat
Kartë memorie SD, kartë memorie SDHC (në përputhje me UHS-I/II), kartë memorie SDXC (në përputhje me UHS-I/II), kartë memorie CF express Type A
Vendi i kartës së kujtesës
SLOT1: Multi slot për kartën e kujtesës SD (UHS-I/II) / CFexpress Card Type A, SLOT2: Slot për kartën e kujtesës SD (UHS-I/II)
Modaliteti i regjistrimit në 2 karta memorie
Simult. Regjistrimi, Renditja, Ndërrimi automatic i medias, Kopjimi
Reduktimi i zhurmës
Reduktimi i zhurmës
NR i ekspozimit të gjatë: On/Off, i disponueshëm me shpejtësi diafrage më të gjata se 1 s, NR ISO i lartë: Normal / Low / Off
Ekuilibri i bardhësisë
Mënyrat e ekuilibrit të bardhësisë
Auto / Drita e ditës / Hije / Renë / Inkandeshente / Fluoreshente / Flash / Nënujore / Temperatura e ngjyrës (2500 deri në 9900 K) & filtri i ngjyrave / Me porosi
Bllokimi AWB i grilës
Po (Mbyll. Gjysma e rrugës poshtë / Vazhdimi i gjuajtjes / Off)
**FOKUSI**
Lloji i fokusit
AF e shpejtë hibride (AF me zbulim faze / AF për zbulimin e kontrastit)
Modaliteti i fokusit

AF-A (AF automatik), AF-S (AF me një goditje), AF-C (AF i vazhdueshëm), DMF (fokus i drejtpërdrejtë manual), fokus manual
Zona e fokusit
Wide / Zone / Center Fix / Spot / Expand Spot / Tracking
Sensori i fokusit
Sensorët Exmor R CMOS
**PIKA E FOKUSIT**
Kornizë e plotë 35 mm: 759 pika (AF me zbulim të fazës), modaliteti APS-C me lente FF: 713 pika (AF me zbulim të fazës), me lente APS-C: 575 pika (AF me zbulim faze) / 425 pika (AF për zbulimin e kontrastit)
Gama e ndjeshmërisë së fokusit
EV-4 në EV20 (ekuivalent i ISO100 me lentet F2.0 të bashkangjitura)
Karakteristika të tjera
Kontrolli parashikues, bllokimi i fokusit, sensat e pistës AF (palëvizshmëri), Ndjeshmëria e zhvendosjes AF Subj. (Film), Shpejtësia e tranzicionit AF (film), Ndërrimi i zonës AF V/H, Regjistrimi i zonës AF, Rrethi i pikës së fokusit, Harta e fokusit (film), Ndihma AF (film)
Ndriçuesi AF
Po (me llojin LED të integruar)
Gama e ndriçuesit AF
PërMinimalisht 0,3 m - Minimalisht 3,0 m (me lente FE 28-70 mm F3.5-5.6 OSS të bashkangjitur)
Lloji i fokusit me LA-EA3 (Shitet veçmas)
Zbulimi i fazës
SYTË AF
[Imazhe të palëvizshme] Njeriu (Zgjedhja e syrit të djathtë/majtas) / Kafsha (zgjedhja e syrit të djathtë/majtas) / Zogu, [filmi] Njeriu (zgjedhja e syrit të djathtë/majtas) / Kafsha (zgjedhja e syrit të djathtë/majtas) / Zogu
Ekspozimi
Kompensimi i ekspozimit
+/- 5.0 EV (1/3 EV, 1/2 EV hapa të zgjedhur)
Lloji i matjes
Matja vlerësuese me 1200 zona
Sensori matës
Sensorët Exmor R CMOS

**NDJESHMËRIA E MATJES**
EV-3 në EV20 (në ekuivalentin ISO100 me lentet F2.0 të bashkangjitura)
Modaliteti i matjes
Me shumë segmente, me peshë qendrore, Spot (Standard / i madh), i gjithë ekrani mesatare, Highlight
Kllapa e ekspozimit
Kllapa: Vazhdim, Kllapa: E vetme, 3/5/9 korniza të zgjedhura. (Drita e ambientit, drita e blic)
Bllokimi AE

Kyçet kur butoni i diafragmës shtypet në gjysmë të rrugës. Në dispozicion me butonin e kyçjes AE. (On/Off/Auto)

**MËNYRAT E EKSPOZIMIT**

[Imazhe të palëvizshme] Intelligent Auto (Auto) / Program Auto (P) / Përparësia e hapjes (A) / Përparësia e diafragmës (S) / Ekspozimi manual (M), [Film] Intelligent Auto (Auto) / Program Auto (P) / Përparësia e hapjes (A) / Përparësia e diafragmës (S) / Ekspozimi manual (M) / Modaliteti fleksibël i exp., [Lëvizje e ngadaltë dhe e shpejtë] Intelligent Auto (Auto) / Program Auto (P) / Përparësia e hapjes (A) / Përparësia e diafragmës (S) / Ekspozimi manual (M) / Modaliteti fleksibël i exp.

Ndjeshmëria ISO (indeksi i rekomanduar i ekspozimit)

Imazhe të palëvizshme: ISO 100-51200 (numrat ISO nga 50 në 204800 mund të vendosen si ISO të zgjeruar), auto (ISO 100-12800, kufiri i poshtëm dhe kufiri i sipërm i zgjedhur), filmat: ekuivalent ISO 100-51200 (numrat ISO deri në 102400 mund të vendosen si ISO të zgjeruar), auto (ISO 100-12800, kufiri i poshtëm dhe kufiri i sipërm i zgjedhur)

Zgjedhja e skenës

-

Gjuajtje kundër dridhjes

Pas

Shikues

Lloji i shikuesit

Shikues elektronik 1,3 cm (lloji 0,5) (Quad-VGA OLED)

Mbulimi në terren

100%

Zmadhimi

PërMinimalisht 0,78x (me lente 50 mm në pafundësi, -1m)

Pika e syrit

Minimalisht 23 mm nga thjerrëza e okularit, 18,5 mm nga korniza e okularit në -1m-1 (standardi CIPA)

Numri i pikave

3 686 400 pika

Rregullimiidioptrisë

-4.0 deri në +3.0 m1

Zgjedhja e shpejtësisë së kuadrove të gjetësit

STD 60 fps / HI 120 fps

Funksioni i ekranit

Histogram, Ekran i rregullimit të imazhit në kohë reale, Matësi i nivelit dixhital, Linja e rrjetit, Kontrolli i fokusit, Peaking MF, Zebra, Shënuesi i filmit, Shfaqja e theksuar gjatë REC

Ekrani LCD

Lloji i monitorit

TFT i tipit 7,5 cm (3,0)

Numri i pikave
1 036 800 pika
Paneli me prekje
Pas
Kontrolli i ndriçimit
Manual (5 hapa midis -2 dhe +2), modaliteti i motit me diell
Këndi i rregullueshëm
Këndiihapjes: Minimalisht 176 °, këndiirrotullimit: Minimalisht 270 °.
Zmadhuesi i fokusit
Po, zmadhuesi i fokusit (kornizë e plotë 35 mm: 5,5x / 11,0x, APS-C: 3,6x / 7,2x)
Rrjeti
lloji
Lloji i rrafshit fokal i kontrolluar në mënyrë elektronike, vertikal
Lloji i grilës
Mekanika e skarës / Elektronika e skarës

**SHPEJTËSIA E DIAFRAGMËS**

Imazhe të paluajtshme: 1/8000 deri në 30 s, Bulb, Filma (modaliteti NTSC): 1/8000 deri në 1/4 (1/3 hapa), deri në 1/60 në modalitetin AUTO (deri në 1/30 në modalitetin e diafragmës automatike të ngadaltë), Filmat (modaliteti PAL): 1/8000 deri në 1/4 (1/3 hapa), deri në 1/50 në modalitetin AUTO (deri në 1/25 në modalitetin e diafragmës automatike të ngadaltë)
Sinkronizimi i blicës. Shpejtësia
1/250 s (kornizë e plotë 35 mm), 1/320 s (APS-C)[10]
Grila elektronike e perdes së përparme
Po (ON/OFF)
Gjuajtje e heshtur
Po (ON/OFF)

Kontrolli i blicit
Kontrolli
TTL11 për të pjekur
Kompensimi i blitzës
+/- 3.0 EV (i ndërrueshëm midis hapave 1/3 dhe 1/2 EV)
Modalitetet e blicit
Flash off, Autoflash, Fill-flash, Slow Sync., Rear Sync., Reduktimi i syve të kuq (i përzgjedhur i aktivizuar/fikur), Wireless12, Sinkronizimi me shpejtësi të lartë.[12]
Koha e riciklimit
-
Pajtueshmëria e jashtme me flash
Sony α System Flash i pajtueshëm me këpucën Multi Interface, lidhni përshtatësin e këpucëve për blic të pajtueshëm me këpucën e aksesorëve të bllokimit automatik
Bllokimi i nivelit FE
Pas

Kontrolli me valë
Po (Sinjali i dritës: E disponueshme me Fill-flash, Slow Sync., Hi-speed sync. / Sinjali radio: E disponueshme me Fill-flash, Rear Sync., Slow Sync., Hi-speed sync.)
Makinë
Vetë-kohëmatës
10 s vonesë / 5 s vonesë / 2 s vonesë / Vetë-kohë e vazhdueshme / Vetë-kohëmatësi i kllapave

**MËNYRAT E DREJTIMIT**

Shkrepje e vetme, shkrepje e vazhdueshme (Hi+/Hi/Mid/Lo e përzgjedhur), Vetë-kohëmatës, Vetë-kohëmatës (Vazhdim), Kllapa: Single, Kllapa: Cont., Kllapa e ekuilibrittëbardhë, kllapa DRO
Shpejtësia e vazhdueshme e drejtimit (approx. max.)
Shkrepja e vazhdueshme: Hi+: 10 fps, Hi: 8 fps, Mid: 6 fps, Lo: 3 fps13
Jo. të kornizave të regjistrueshme (për Minimalisht)
JPEG Extra fine L: mbi 1000 korniza, JPEG Fine L: mbi 1000 korniza, JPEG Standard L: mbi 1000 korniza, RAW: mbi 1000 korniza, RAW & JPEG: mbi 1000 korniza, RAW (Lossless Compressed): mbi 1000 korniza, RAW (Lossless Compressed) & JPEG: mbi 1000 korniza, RAW (I pakompresuar): mbi 1000 korniza, RAW (i pakompresuar) & JPEG: 828 korniza13
Pixel Shift Multi Shooting-
Për Minimalisht 658 g (Minimalisht 1 lb 7.3 oz)
-
Stabilizimi i imazhit
lloji
Mekanizmi i zhvendosjes së sensorit të imazhit me kompensim me 5 boshte (Kompensimi varet nga specifikimet e lenteve)
Efekti i kompensimit
5.5 ndalesa (bazuar në standardin CIPA. Vetëm tundje pitch/yaw. Me lente Planar T* FE 50 mm F1.4 ZA të montuara. NR ekspozimi i gjatë i fikur.)
Kompensimi i lenteve
Vendosja
Hije periferike, aberracion kromatik, shtrembërim, frymëmarrje (film)

Të tjerët
Temperatura e funksionimit
0 - 40 °C / 32 - 104 °F
Audio
Mikrofoni
E integruar, stereo
Folësi
E integruar, monofonale

Ndërfaqja
Opsion me shumë ndërfaqe
Po (me ndërfaqe audio dixhitale)[15]
Ndërfaqja e kompjuterit
Ruajtja masive / MTP
Multi / Micro USB Terminal
Po14
Bluetooth
Pas (Bluetooth Standard Ver. 4.1 (pa 2.4 GHz))
Terminali i mikrofonit
Po (minijack stereo 3.5 mm)
Sinkronizoni terminalin
-
Terminali i kufjeve
Po (minijack stereo 3.5 mm)
Lidhës vertikal i kapjes
Pas
Terminalet LAN
-
Funksionet
Funksioni i transferimit FTP. (Wireless LAN (USB-LAN), USB Tethering, Wi-Fi), View on Smartphone, Telekomandë përmes smartphone, Telekomandë PC, BRAVIA Sync (Control for HDMI), PhotoTV HD
Aksesueshmëria
LEXUESI EKRANI
Po (Gjuha: Anglisht, Shpejtësia: 7 hapa, Vëllimi: 16 hapa)[16]
Fuqia
Furnizimi me energji USB
Po (E disponueshme me terminalin USB Type-C. USB Power Delivery i pajtueshëm)
Bateria e furnizuar
Një paketë baterie të rikarikueshme NP-FZ100
Jetëgjatësia e baterisë (imazhe të palëvizshme)
Për Minimalisht 520 shkrepje (shikues) / rreth 580 shkrepje (monitor LCD) (standardi CIPA)[17]
Jetëgjatësia e baterisë (Filmi, regjistrimi aktual)
Për Minimalisht 100 min (shikuesi) / Minimalisht 110 min (monitor LCD) (standardi CIPA)[18]
Jetëgjatësia e baterisë (film, regjistrim i vazhdueshëm)
Për Minimalisht 170 min (shikuesi) / Minimalisht 175 min (monitor LCD) (standardi CIPA)
Ngarkimi i brendshëm i baterisë
Po (E disponueshme me terminalin USB Type-C. USB Power Delivery i pajtueshëm)
Konsumiienergjisë me ekran LCD
Imazhe të paluajtshme: Minimalisht 3,4 W (me lente OSS FE 28-70 mm F3.5-5.6 të bashkangjitur), filma: Minimalisht 5,6 W (me lente OSS FE 28-70 mm F3.5-5.6 të bashkangjitur)

Lentet
Montimi i lenteve
Elektronika Montimi

## 2. **<u>SPECIFIKIMET MINIMALE TEKNIKE PËR LENTE APARATI FOTOGRAFIK PROFESIONALE 70-200MM</u>**

Formatet
Kornizë e plotë 35 mm
Grupet / Elementet e lenteve
14-17
Këndiishikimit (APS-C)
23°- 8°6
Hapjamaksimale (F)
2.8
Hapjaminimale (F)
22
Raporti maksimal I zmadhimit (x)
0.3
Gjatësia fokale (mm)
70 mm - 200 mm
Gjatësia fokale ekuivalente 35 mm (APS-C)
105 mm - 300 mm6
Këndi I shikimit (35 mm)
34°-12° 30'
Tehet e hapjes
11
Hapje rrethore
Pas
Distanca minimale e fokusit
0.4 - 0.82 m (1.32 - 2.69 ft)
Diametri I filtrit (mm)
77
Stabilizimi I imazhit (Steady Shot)
Gjuajtje optike e qëndrueshme
Sistemi i zmadhimit
Manualet
Përputhshmëria e telekonvertuesit (x1.4)
SEL14TC
Përputhshmëria e telekonvertuesit (x2.0)
SEL20TC
Lloji i kapuçit
Formë e rrumbullakët, lloji I bajonetës

Madhësia dhe pesha

Pesha
1045 g (36.9 oz.) (Pa montim trekëmbësh)
Dimensioni (D x W)
88 x 200 mm (3-1/2 x 7-7/8 in.)
Me një shikim
Gjatësia fokale
70 - 200 mm
Maksimumi I hapjes
f / 2.8
Madhësia dhe pesha
Φ3.5" x 7.875" / 36.86 oz.

## 3. SPECIFIKIMET MINIMALE TEKNIKE PER: LENTE APARATI FOTOGRAFIK PROFESIONALE 24-70MM

| | |
|---|---|
| Mali | Montimi elektronik |
| Formati | Kornizë e plotë 35 mm |
| Gjatësia fokale (mm) | 24-70 |
| Gjatësia fokale ekuivalente 35 mm (APS-C) | 36-105 |
| Grupet / Elementet e lenteve | 15-20 |
| Këndi i shikimit (35 mm) | 84°-34° |
| Këndi i shikimit (APS-C) | 61°-23°1 |
| Hapja maksimale (F) | 2.8 |
| Hapja minimale (F) | 22 |
| Tehet e hapjes | 11 |
| Hapje rrethore | Po |
| Distanca minimale e fokusit | 0.21 (W) -0.3 (T) m (0.69 (W) -0.99 (T) ft) |
| Raporti maksimal i zmadhimit (x) | 0.32 x |
| Diametri i filtrit (mm) | 82 |
| Stabilizimi i imazhit | - (i integruar në trup) |
| Sistemi i zmadhimit | Manuali |
| Përputhshmëria e telekonvertuesit (x1.4) | - |
| Përputhshmëria e telekonvertuesit (x2.0) | - |

## 4. SPECIFIKIMET TEKNIKE MINIMALE PËR: KARTË MEMORJE 64GB

Lloji I kartës së memorjes: CFexpress Type A (2.0 & 4.0) ose UHS-I and UHS-II (SDHC/SDXC) SD
Hapwsira e ruajtjes: 64Gb
Të tjera: Të jetë e optimizuar për aparate fotografik

**5. SPECIFIKIMET TEKNIKE MINIMALE PËR:TRIPOD PROFESIONAL**

Pesha e trekëmbëshit min: 1.55 Kg
Lartësia maksimale min: 160 cm
Pesha e ngarkesës së sigurisë min: 8 kg
Pjerrësia përpara min: +90°/38°
Lloji I kokës: Ball Headdhe/ose ekuivalent
Materiali: alumin dhe/ose ekuivalent
Lloji I pllakës min: 200LT-PL-PRO

**6. SPECIFIKIMET TEKNIKE MINIMALE PËR:MIKROFON PROFESIONAL ME WIRELESS CIFT (PERFSHIRE ADAPTORET)**

**Transmetuesi**

- **Modaliteti me valë**
- GFSK 1 Mbps dhe 2 Mbps
- **Fuqiae kuivalente e rrezatuar izotropike (EIRP)**
- <20 dBm
- **Frekuenca e funksionimit të modalitetit me valë**
- 2.400-2.4835 GHz
- **Protokolli Bluetooth**
- BR/EDR
- **Frekuenca e funksionimit Bluetooth**
- 2.400-2.4835 GHz
- **Fuqia e transmetuesit Bluetooth (EIRP)**
- <20 dBm
- **Lloji I baterisë**
- Li-jondhe/oseekuivalent
- **Kapaciteti I baterisë**
- 360 mAh
- **Energjia e baterisë**
- 1.39 Wh
- **Tensioniibaterisë**
- 3.87 V
- **Specifikimi I karikimit**
- Maksimumi 5 V
- **Temperatura e karikimit**

- 5° derinë 45° C (41° derinë 113° F)
- **Temperatura e funksionimit**
- -10° derinë 45° C (14° derinë 113° F)
- **Koha e karikimit**
- Min 70 minuta
- **Koha e funksionimit**
- Min 6 orë

**Marrësi**

- **Modaliteti me valë**
- GFSK 1 Mbps dhe 2 Mbps
- **Fuqiaekuivalente e rrezatuar izotropike (EIRP)**
- <20 dBm
- **Frekuenca e funksionimit**
- 2.400-2.4835 GHz
- **Lloji I baterisë**
- Li-jondhe/oseekuivalent
- **Kapaciteti I baterisë**
- Min 360 mAh
- **Energjia e baterisë**
- 1.39 Wh
- **Tensioni I baterisë**
- 3.87 V
- **Specifikimi I karikimit**
- Maksimumi 5 V
- **Temperatura e karikimit**
- 5° derinë 45° C (41° derinë 113° F)
- **Temperatura e funksionimit**
- -10° derinë 45° C (14° derinë 113° F)
- **Koha e karikimit**
- Min 70 minuta
- **Koha e funksionimit**
- Min 6 orë

**Kutia e karikimit**

- **Lloji i baterisë**
- 18650 Li-jondhe/oseekuivalent
- **Kapaciteti I baterisë**
- Min 3250 mAh
- **Energjia e baterisë**
- 11.7 Wh
- **Tensioni I baterisë**
- 3.6 V

- **Specifikimi I karikimit**
- Maksimumi 5 V, 1.5-3 A
- **Temperatura e karikimit**
- 5° derinë 40° C (41° derinë 104° F)
- **Temperatura e funksionimit**
- 5° derinë 45° C (41° derinë 113° F)
- **Koha e karikimit**
- Min 2 orë e 40 minuta
- **Ciklet e karikimit për TX dhe RX**
- Minimalisht dy cikle kur karikon I dy TX dhe një RX në të njëjtën kohë

**Të përgjithshme**

- **Modeli polar**
- E gjithanshme
- **Përgjigja e frekuencës**
- Prerja e ulët: 50 Hz - 20 kHz Prerja e ulët e ndezur: 100 Hz - 20 kHz
- **Niveli maksimal I presionit të zërit (SPL)**
- 120 dB SPL
- **Niveli maksimal I hyrjes (3.5 mm)**
- -6 dBV (THD < 0.1%)
- **Zhurmë ekuivalente**
- 21 dBA
- **Monitoroni fuqinë dalëse të ndërfaqes**
- Daljamaksimale 12 mW@1 kHz, 32 Ω
- **Distanca maksimale e transmetimit**
- 250 m (FCC)160 m (CE)

7. **<u>SPECIFIKIMET TEKNIKE MINIMALE PËR: STABILIZUES GIMBAL PROFESIONAL</u>**

**Portat e akesorwve**

- 1/4"-20 Mounting Hole
  Cold Shoe
  Video Transmission Port (USB-C)
  RSS Camera Control Port (USB-C)
  Focus Motor Port (USB-C)

**Bateria**

- Lloji: LiPo dhe/ose ekuivalent
- Kapaciteti: Min 3000 mAh
- Energjia: 21 Wh
- Max Kohëzgjatja: 12 orë (Matet me gimbalin të balancuar në një gjendje të nivelit dhe të palëvizshme. Kur gimbali është në lëvizje, koha e funksionimit do të zvogëlohet.)

- Koha e karikimit: Minimalisht 2.5 orë (Matet me një karikues që mbështet karikimin e shpejtë 18 W.)

**Lidhjet**

- Porta e karikimit Bluetooth 5.1 (USB-C)
- **Kërkesat e aplikacionit**
- iOS 11.0 ose më lart Android 8.0 ose më lart
- **Gjuhët e mbështetura nga ekrani me prekje**
- Anglisht, Kinezce e thjeshtuar, Kinezce tradicionale, Gjermanisht, Frëngjisht, Koreanisht, Japonisht, Spanjisht, Portugalisht (Brazil), Russisht, Tajlandisht, etj.

**Performanca e punës**

- **Ngarkesa e testuar**
- Min. 3 kg (6.6 lbs)
- **Shpejtësia maksimale e kontrolluar e rrotullimit**
- Panoramica: 360°/sAnimi: 360°/s Rrotullimi: 360°/s
- **Gama mekanike**
- Boshti i tiganit: rrotullim i vazhdueshëm 360° Boshti irrotullimit: -95° deri në +240° Boshti I animit: -112° deri në +214°

**Vetitë mekanike dhe elektrike**

- **Frekuenca e funksionimit**
- 2.400-2.4835 GHz
- **Fuqia e transmetuesit Bluetooth**
- < 8 dBm
- **Temperatura e funksionimit**
- -20° deri në 45° C (-4° derinë 113° F)

**Transmetuesi i imazhit**

**Lidhjet**

- Porta e energjisë/komunikimit (USB-C)PORTA HDMI (Mini HDMI) Porta e kontrollit të kamerës RSS (USB-C)

**Porti i zgjerimit**

- Cold Shoe

**Frekuenca e funksionimit**

- 2.400-2.4835 GHz5.725-5.850 GHz

**Fuqia e transmetuesit (EIRP)**

- 2.400-2.4835 GHz:< 25 dBm (FCC)< 20 dBm (CE/SRRC/MIC)

  5.725-5.850 GHz:< 25 dBm (FCC/SRRC)< 14 dBm (CE)

**Bateri**

- Kapaciteti: Min 2970 mAh
- Karikuesi i pajtueshëm: 5 V/2 AC
- koha e chargimit: Minimalisht 2.5 orë
- Koha e funksionimit: Minimalisht 3.5 orë

**Gama e transmetimit**

- Min. 200 m (SRRC/FCC)100 m (CE)

Shënim: Për çdo çertifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

**NJËSIA E PROKURIMIT**